

GJYKATA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 1377/16

**PRODHIM VESHJE NR. 2 SHA
KUNDËR SHQIPËRISË**

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 26 shtator 2023, si Komitet i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *President,*

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë,*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelare e Seksionit,*

Duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 1377/16) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë, sipas nenit 34 të Konventës për Mbrotjtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (“Konventa”), më 30 dhjetor 2015, nga Prodhim Veshje nr. 2 sh.a., një shoqëri tregtare e themeluar në Shqipëri (“shoqëria kërkuuese”), e përfaqësuar nga z. B. Rusi, avokat i licencuar në Tiranë;

vendimin për të njoftuar Qeverinë e Shqipërisë (“Qeveria”), të përfaqësuar nga Agjentja e saj e asaj kohe, znj. A. Hicka dhe më pas nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit, për ankimin sipas nenit 6 § 1 të Konventës, në lidhje me të drejtën e shoqërisë kërkuuese për akses në gjykatë dhe të drejtën për vendim të arsyetuar, si edhe për ankimin sipas nenit 1, të Protokollit nr. 1, të Konventës, në lidhje me vendimin e gjykatës që e urdhëron të paguajë dëmshpërblim dhe për të shpallur të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës;

parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

14. Çështja ka të bëjë me shkeljen e dyshuar të së drejtës së shoqërisë kërkuuese për gjykim të drejtë dhe të së drejtës për gëzimin e qetë të pronës së saj.

15. Në vitin 2006, një palë private, A.M filloi ndërtimin në një parcelë toke të pretenduar nga shoqëria kërkuuese. Në vitin 2007, shoqëria kërkuuese depozitoi një padi civile ku kërkoi ndërprerjen e këtij ndërtimi. Më 4 dhjetor 2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (Gjykata e Rrethit) mori një vendim për *masën e sigurimit të padisë*, duke e ndaluar ndërtimin. Kjo padi u sigurua me një depozitë bankare 100.000 EUR të depozituar nga shoqëria kërkuuese. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë. Më 29 shtator 2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor rrëzoi pretendimin kryesor të shoqërisë kërkuuese dhe hoqi masën e sigurimit të padisë. Më 5 shkurt 2010, Gjykata e Apelit la në fuqi vendimin, dhe mori formën e prerë.

16. Më 19 shkurt 2010, A.M dhe shoqëria “A” depozituan një padi civile kundër shoqërisë kërkuuese për pagimin e dëmshpërblimit që rezultoi nga marrja e masës së sigurimit të padisë dhe pezullimi i punimeve të ndërtimit, që u kërkuar nga shoqëria kërkuuese.

17. Avokati, përfaqësues i shoqërisë kërkuuese, me anë të një prokure përfaqësimi, mori pjesë në seancat e mbajtura më 28 korrik, 30 shtator, 26 tetor 2010 dhe 20 shkurt 2012. Në seancën e mbajtur më 28 korrik 2010, ai i kërkoi gjykatës një kopje të padisë dhe prova të paraqitura nga paditësi, të cilat i ishin dorëzuar atij në atë seancë. Më 26 tetor 2010, ai kërkoi pezullimin e procesit, në pritje të rezultatit të procedimit penal të filluar kundër A.M për ankimin e shoqërisë kërkuuese për falsifikimin

e dyshuar të një dokumenti. Kërkesa u refuzua. Me kërkesë të avokatit të shoqërisë kërkuese, Gjykata e Rrethit Gjyqësor e shtyu seancën e planifikuar për në 4 dhe 27 prill, 29 qershor, 15 korrik, 7 dhjetor 2011 dhe 4 maj 2012. Gjykata refuzoi kërkesat e tjera për shtyrje të seancave të planifikuara më 20 maj dhe 3 qershor 2011 dhe 8 maj 2012 sepse kërkesat nuk mbështeteshin me provat përkatëse ose nuk bazoheshin në shkaqet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.

18. Në seancën e mbajtur më 20 shkurt 2012, dy ekspertë kontabël dhe pasurie të paluajtshme, të caktuar nga gjykata, u thirrën për të dhënë dëshmi me gojë. Me kërkesë të avokatit të shoqërisë kërkuese, Gjykata e Rrethit Gjyqësor e shtyu atë seancë, me qëllim që ai të mund të konsultohet me opinionin e ekspertëve, për të cilin mori një kopje në atë seancë. Në seancën e mbajtur më 13 mars 2012, gjykata vendosi të vazhdojë pa praninë e avokatit të shoqërisë kërkuese meqenëse ai mungonte pa dhënë arsye dhe nuk kishte paraqitur kërkesë për shtyrje.

19. Administratori i shoqërisë kërkuese ose avokati i saj nuk morën pjesë në seanca të tjera përpara Gjykatës së Rrethit, edhe pse Gjykata e Rrethit kishte dërguar njoftimet për këto seanca. Njoftimet e shoqërisë kërkuese ishin bërë në adresën e dhënë në padi nga paditësi. Shoqëria kërkuese kishte përdorur të njëjtën adresë vetë kur paraqiti kërkesën e saj për pezullimin e procesit (shihni paragrafin 17 më sipër). Njoftimet e dërguara avokatit të shoqërisë kërkuese ose u firmosën personalisht prej tij ose nga zëvendësit e tij. Avokati i shoqërisë kërkuese nuk paraqiti ndonjë kundërshtim në Gjykatën e Rrethit në lidhje me adresat e klientit të tij.

20. Më 16 maj 2012, Gjykata e Rrethit e pranoi pretendimin pjesërisht dhe urdhëroi shoqërinë kërkuese që të paguante dëmshpërblime dhe kamata në shumën 861.672 EUR; të transferonte garancinë bankare te paditësi; si edhe të paguante 7.174.244 lek (përafërsisht 51.650 EUR në atë kohë) si pagesë e bërë nga paditësi ndaj palëve të tjera si pasojë e masës së sigurimit të padisë.

21. Shoqëria kërkuese e ankimoi atë vendim. Në ankimin e saj ajo dha të njëjtën adresë ku Gjykata e Rrethit dërgoi njoftimet për seancat. Gjykata e Apelit njoftoi të gjitha palët për seancat e saj me anë të një njoftimi publik. Më 18 prill 2013, Gjykata e Apelit, pa praninë e përfaqësuesit të shoqërisë kërkuese, la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit. Ankimimi i shoqërisë kërkuese për çështje ligjore, ku përsëri jepej e njëjta adresë, u rrëzua *de plano* nga Gjykata e Lartë, më 24 korrik 2014.

22. Më 16 maj 2015, shoqëria kërkuese depozitoi një ankim kushtetues ku pretendonte shkeljen e të drejtës për t'u dëgjuar nga gjykata; mosarsyetimin e vendimeve të gjykatës; pjesëmarrjen e parregullt të një gjyqtari në kolegjin e Gjykatës së Apelit; dhe shkeljen e nenit 1 të Protokollit 1.

Më 16 korrik 2015, Gjykata Kushtetuese, e mbledhur në panel të përbërë nga tre gjyqtarë, shpalli të papranueshëm ankimin kushtetues të shoqërisë kërkuese.

-VLERËSIMI I GJYKATËS

A. Shkelja e dyshuar e nenit 6 § 1 të Konventës, në lidhje me të drejtën e aksesit në gjykatë

23. Shoqëria kërkuese argumentoi që e drejta për akses në gjykatë ishte shkelur për shkak se Gjykata e Rrethit nuk kishte siguruar pjesëmarrjen e administratorit në të gjitha seancat e mbajtura përpara asaj gjykate dhe të avokatit të saj në disa seanca. Rrjedhimisht, pretendoi që nuk ishte në gjendje të paraqiste kundërshtimet e saj ndaj pretendimeve të palës kundërshtare përpara Gjykatës së Rrethit dhe që gjykata nuk i kishte dhënë mundësinë e duhur që të komentonte për gjetjet e ekspertit, në lidhje me shumën e dëmshpërblimit të pretenduar nga pala kundërshtare. Shoqëria kërkuese gjithashtu u shpreh që njoftimet e seancave gjyqësore ishin dërguar në dy adresa të gabuara.

24. Gjykata nuk e ka për detyrë të caktojë mënyrën e preferuar të komunikimit me palët ndërgjyqëse, duke qenë se gjykatat e brendshme janë në kushte më të mira për të vlerësuar situatën nisur nga rrethana praktike (shihni *çështja Gankin dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 2430/06, 1454/08, 11670/10 dhe 12938/12, § 35, 31 maj 2016). Megjithatë, Shtetet Kontraktuese kanë përgjegjësinë të

sigurohen që autoritetet e brendshme kanë vepruar me vigjilencën e kërkuar për njoftimin e palëve mbi procesin, me qëllim që të mos kërcënohet e drejta e tyre për gjykim të drejtë. Kjo përgjegjësi ekziston bashkë me detyrimin e kërkuarve që të mos kontribuojnë për të krijuar situata për të cilat ata ankohen përpara Gjykatës (shihni *çështja Avotiņš kundër Letonisë* [GC], nr. 17502/07, § 124, GJEDNJ 2016).

25. Në çështjen në fjalë, Gjykata e Rrethit dërgoi të gjitha njoftimet në adresën e shoqërisë kërkuese që ajo vetë përdori në të gjithë korrespondencën me Gjykatën e Rrethit, në ankimin e saj dhe në ankimin për çështjet ligjore. Gjithashtu, Gjykata e Rrethit njoftoi avokatin e shoqërisë kërkuese për të gjitha seancat. Sipas Gjykatës, Gjykata e Rrethit njoftoi rregullisht shoqërinë kërkuese dhe përfaqësuesin e zgjedhur të saj për seancat e saj. Avokati i shoqërisë kërkuese në fakt mori pjesë në disa seanca (shihni paragrafin 18 më sipër) dhe kërkoi shtyrjen e seancave të tjera dhe Gjykata e Rrethit pranoi disa nga këto kërkesa (shihni paragrafët 18 dhe 19 më sipër).

26. Vetëm pasi avokati i shoqërisë kërkuese nuk u paraqit në seancën e mbajtur më 13 mars 2012 pa kërkuar shtyrjen e saj ose pa dhënë arsye për mungesën e tij, Gjykata e Rrethit vendosi të vazhdojë pa praninë e avokatit të shoqërisë kërkuese. Pas kësaj, as administratori i shoqërisë kërkuese, as avokati i saj nuk morën pjesë në seanca të tjera përpara Gjykatës së Rrethit, edhe pse Gjykata e Rrethit e ka dërguar njoftimin për këto seanca. Sipas Gjykatës këto rrethana tregojnë se përfaqësuesit e shoqërisë kërkuese kanë krijuar situatën për të cilën ata po ankohen përpara Gjykatës. Gjithashtu, Gjykata vëren që avokati i shoqërisë kërkuese nuk ka kundërshtuar adresat ku Gjykata e Rrethit ka dërguar njoftimet e seancave. As shoqëria kërkuese nuk ka kundërshtuar në lidhje me sjelljen e avokatit të saj përpara gjykatave të brendshme ose përpara Gjykatës.

27. Pretendimi i shoqërisë kërkuese që mosmarrja pjesë e administratorit të saj në ndonjë seancë, pavarësisht nga prania e avokatit të saj, përbën shkeljen e së drejtës së saj për gjykim të drejtë, nuk mbështetet nga ndonjë dispozitë ligjore e brendshme. Shoqëria kërkuese zgjodhi të përfaqësohej nga avokati i saj dhe i dha atij prokurën e përfaqësimit me autoritet për të vepruar në emër të saj. Në procese civile praktika e kërkon që prania e palëve të realizohet me përfaqësimin nga avokatët e zgjedhur prej tyre.

28. Në lidhje me ankimin e shoqërisë kërkuese që nuk kishte mundësi të bënte parashtrime për opinionin e ekspertit, Gjykata vëren që seanca e 12 shkurtit 2012 u shty me kërkesë të avokatit të shoqërisë kërkuese në mënyrë që ai të jepte komentet e tij për opinionin e ekspertit. Gjykata konsideron që kështu u morën masat e kërkuara për të siguruar që shoqëria kërkuese të kishte mundësinë për të komentuar për opinionin e ekspertit.

29. Gjithashtu, Gjykata vëren që shoqëria kërkuese nuk ka paraqitur ankim në lidhje me mënyrën se si është informuar për seancën përpara Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë.

30. Prandaj, Gjykata konkludon që nuk ka tregues që gjykatat e brendshme kanë shkelur të drejtën e shoqërisë kërkuese për të marrë pjesë në proces, për të paraqitur argumentet e saj ose për të kundërshtuar konkluzionet e opinioneve të ekspertit. Autoritetet ishin vigjilente për të informuar shoqërinë kërkuese për procesin dhe mund të pritej që kjo e fundit të bënte kujdes për të marrë postën në adresën e saj të deklaruar (shihni, për një situatë të ngjashme, *çështja Immoterra International Denia, s.l. kundër Spanjës* [Komiteti], nr. 60484/16, § 34, 26 maj 2020, me referenca të mëtejshme). Shoqëria kërkuese është përgjegjëse për situatën për të cilën ankohet në Gjykatë.

31. Për rrjedhojë, kjo pjesë e kërkesës është haptazi e pabazuar dhe duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

B. Shkelje të tjera të dyshuara

32. Shoqëria kërkuese depozitoi një ankim shtesë sipas nenit 6 § 1 të Konventës me pretendimin që gjykatat e brendshme nuk kishin arsyetuar mjaftueshëm vendimet e tyre, sidomos në lidhje me mënyrën e llogaritjes së dëmshpërblimit.

33. Në lidhje me ankimin, Gjykata bie dakord me Qeverinë që gjykatat e brendshme kanë arsyetuar si duhet vendimet e tyre, duke trajtuar pikat e ngritura nga palët. Arsyet faktike dhe ligjore për vendimet e Gjykatave të Rrethit dhe të Apelit që pranuan pretendimin u paraqitën me detaje. Gjithashtu, vendimi i Gjykatës së Lartë për të refuzuar *de plano* ankimin e shoqërisë kërkuese për çështjet ligjore pa dhënë arsye të shtjelluara nuk përbën shkelje të nenit 6 § 1 (shihni *çështja Marini kundër Shqipërisë*, nr. 3738/02, § 106, 18 dhjetor 2007). Prandaj, ankimi i shoqërisë kërkuese për shkeljen e dyshuar të të drejtës së saj për një vendim të arsyetuar është haptazi i pabazuar.

34. Gjithashtu shoqëria kërkuese paraqiti ankimin sipas nenit 1, të protokollit nr. 1, me pretendimin e shkeljes të së drejtës së saj për gëzimin e qetë të pronës, sepse urdhri i gjykatës për dëmshpërblim përbënte barrë të tepërt mbi të. Gjykata vëren që në këtë çështje, shoqëria kërkuese u ankua më së shumti për mënyrën se si gjykatat kombëtare e ishin interpretuar dhe zbatuar legjislacionin e brendshëm në procesin ndërmjet dy palëve private. Nisur nga vlerësimi më sipër sipas nenit 6 § 1 të Konventës, Gjykata përsërit që kompetenca e saj për të verifikuar që legjislacioni i brendshëm është interpretuar dhe zbatuar si duhet është e kufizuar dhe që nuk e ka për detyrë të zërë vendin e gjykatave të brendshme, sepse roli i saj është të sigurohet që vendimet e atyre gjykatave të mos jenë me gabime për shkak të arbitraritetit ose përndryshe haptazi të paarsyeshme (shihni *çështja Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë* [GC], nr. 73049/01, § 83, GJEDNJ 2007-I).

35. Gjykata nuk gjen arsye për të dalë në konkluzionin që vendimet e gjykatave të brendshme janë ndikuar nga ndonjë element i arbitraritetit ose që ato përndryshe janë haptazi të paarsyeshme.

36. Nisur nga sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin që vendimet e gjykatave të brendshme në çështjen në fjalë nuk përbëjnë ndërhyrje në të drejtën e shoqërisë kërkuese për të gëzuar qetësisht pasurinë e saj.

37. Për rrjedhojë, kjo pjesë e kërkesës është gjithashtu haptazi e pabazuar dhe duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht,

Shpall kërkesën të papranueshme.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 19 tetor 2023.

Olga Chernishova
ZËVENDESKANCELARE

Georgios A. Serghides
PRESIDENT